V E N D I M
Nr. 311, datë 5.7.1999

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 288, DATË 18.6.1999 "PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË TELEKOMUNIKACIONEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në pikën 3 pas paragrafit të dytë, në dokumentin i cili i bashkëlidhet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 18.6.1999, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

"ALBTELECOM sh.a. në marrëveshjen e lidhur me NEW WORLD TELECOM LLC të pranojë kushtin e kërkuar nga kjo shoqëri, si vijon:

" Seksioni i 12 ekskluziviteti dhe jokonkurRenca:

Asnjë palë ose filial i cilësdo palë (qoftë duke vepruar vetëm, në partneritet ose me ndonjë ndërmarrje të përbashkët ose ndryshe): (i) nuk do t'i paraqesë ndonjë ofertë ndonjë autoriteti qeveritar, në lidhje me mundësitë; (ii) në çdo mënyrë nuk do t'u sigurojë mbështetje personave të interesuar në lidhje me mundësitë; ose (iii) nuk do të hyjnë në ndonjë marrëveshjeje tjetër, që mendohet, në mënyrë të arsyeshme, të konkurrojë me shoqërinë ose ndonjë filial të shoqërisë në Shqipëri. Asnjëra nga palët e kësaj marrëveshjeje nuk do të marrë pjesë në ndonjë veprimtari biznesi në Shqipëri, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në konkurrencë me shoqërinë në ndonjë biznes që shoqëria ka në përputhje me këtë marrëveshje dhe në bazë të ndonjë marrëveshjeje tjetër të përbashkët të ALBTELECOM-it dhe NWT-së, vendosur për të ndërmarrë, duke përfshirë, por pa u kufizuar te mundësitë"".

2. ALBTELECOM, sh.a. për detyrimet që ka, sipas pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 18.6.1999, për të lidhur së paku katër linja në komunë, ka të drejtë të bashkëpunojë me operatorë të tjerë vendorë, ruralë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko